



Republic of Macedonia
Ministry of Finance
PUBLIC REVENUE OFFICE

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKI I KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo Finansne / Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Preredska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Z.O
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	09-06-3670
Nr. i foleve Broj stranica No. pages:	—
Data Datum Date:	10 / 10 / 2018
PRISHTINE / A	

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT NDËRMJET

MINISTRISË SË FINANCAVE – ZYRA E TË HYRAVE PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE MINISTRISË SË FINANCAVE - ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (këtej e tutje referuar si “Memorandumi”) është nënshkruar ndërmjet:

Ministrisë së Financave – Zyra e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë, përfaqësuar nga Drejtoresha, Sanja Lukarevska

dhe

Ministria e Financave - Administratës Tatimore të Kosovës, përfaqësuar nga Drejtori, Sakip Imeri.

Ministria e Financave – Zyra e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Financave - Administrata Tatimore e Kosovës këtej e tutje referohen së bashku si “Palët” dhe individualisht si “Pala”.

PREAMBULA

- Duke pasur parasysh vullnetin për përmirësimin e bashkëpunimit, avancimin e raporteve të ndërsjella që kanë për qëllim zhvillimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushat prioritare të secilës Palë,
- Duke pasur parasysh rëndësinë e rritur të asistencës së ndërsjellë, besimit, mirëkuptimit dhe luftës së përbashkët kundër evazionit fiskal,
- Duke shprehur në promovimin e metodave të avancuara për mbledhjen e tatimeve nëpërmjet transferimit të njohurive dhe përvojës në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën me interes të përbashkët,
- Duke konfirmuar vendosmërinë në respektimin e legjislacionit të të dyja Palëve në fushat e bashkëpunimit brenda fushëveprimit të kompetencave të institucioneve,

— Duke dëshiruar arritjen e një bashkëpunimi të frytshëm në fushën e modernizimit të operimeve,

Palët janë pajtuar si në vijim:

Neni 1 Parimet themelore

Parimi themelor i këtij Memorandumi është inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Kosovës.

Dispozitat e këtij Memorandumi nuk mund të përdoren për ngritjen e ndonjë pretendimi (kërkese) ligjor në emër të cilësdo Palë apo pale të tretë. Dispozitat e këtij Memorandumi nuk paragjykojnë e as nuk supozojnë vendime apo aktivitete të veçanta që do të ishin të detyrueshme dhe t'i shqiptoheshin cilësdo nga Palët apo një pale të tretë.

Dallimet e Palëve në interpretim apo zbatim të këtij Memorandumi zgjidhen në mënyrë miqësore me marrëveshje të ndërsjellë.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në përputhje me këtë Memorandum në fushat brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, me qëllim të shkëmbimit të përvojës, transferimit të njohurive dhe praktikave më të mira, përmirësimit të performancës së Palëve, dhe stimulimit të përmbushjes vullnetare tatimore, si dhe parandalimit, zbulimit dhe luftimit të evazionit tatimor në të dyja vendet.

Neni 3 Koordinimi dhe shpenzimet financiare

Palët vendosin për aktivitetet konkrete për bashkëpunim sipas këtij Memorandumi.

Fushëveprimi dhe afati kohor i secilit element të bashkëpunimit përcaktohet në mënyrë reciproke me pëlqimin e të dyja Palëve.

Secila Palë mund të emëroj personin/personat e duhur për kontakt dhe/ose për të koordinuar aktivitetet për bashkëpunim sipas këtij Memorandumi.

Secila Palë mbulon kostot e saj që paraqiten gjatë zbatimit të këtij Memorandumi.

Neni 4
Konfidencialiteti

Secila Palë zotohet të respektojë dhe të veprojë në përputhje me dispozitat e ndërlidhura me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave që rregullohen me ligjet dhe rregulloret në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Kosovës.

Neni 5
Ndryshimet e dispozitës

Dispozita e këtij Memorandumi mund të ndryshohet në çdo kohë dhe sipas kushteve të njëjta të nxjerrjes, me pëlqimin paraprak me shkrim të të dyja Palëve.

Nëse ndonjë dispozitë e këtij Memorandumi, për çfarëdo shkak dhe në cilëndo nga të dyja Palët, bëhet e pavlefshme, e pazbatueshme apo e paligjshme, dispozita e tillë ndryshohet me njoftimin paraprak nga Pala ku ka ndodhur shkak i ndryshimit dhe me nënshkrimin e një shtojce në këtë Memorandum ndërmjet Palëve.

Ndryshimet në dispozitë nuk prekin pjesën e mbetur të këtij Memorandumi, e cila mbetet në fuqi dhe efekt.

Neni 6
Përfundimi i memorandumit

Ky Memorandum përfundon pas skadimit të 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për përfundimin e Memorandumit nga cilado Palë.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord reciprokisht për mënyrën e zgjidhjes së të gjitha çështjeve të pazgjidhura në këtë drejtim.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy Palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohore.

Memorandumi nënshkruhet në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, ku secili tekst është autentik në mënyrë të barabartë. Në rast të divergjencës në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Ky Memorandum është nënshkruar në

PRISHTINË

më 10 / 10 / 2018 .

Palët nënshkruese të memorandumit:

Republika e Maqedonisë
Ministria e Financave
Zyra e të Hyrave Publike

Sanja Lukarevska

Republika e Kosovës
Ministria e Financave
Administrata Tatimore e Kosovës

Sakip Imeri